



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË**
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 769 Prot.

Tiranë, më 11 . 02 .2020

URDHËR

Nr. 10 , Datë 11.02.2020

PËR

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT “REZULTATET E TË NXËNIT PËR REALIZIMIN E
NIVELIT MINIMAL TË KOMPETENCAVE PËR TESTET E MSH 2020”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.537, datë 08.11.2019, “Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri: “Rezultate e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testet e MSH 2020”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Rezana VRAPI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

Tel/fax. +355 4 2419257

Web site: www.qsha.gov.al

E-mail: rezana.vrapi@qsha.gov.al

PROVIMET E DETYRUARA:

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsi në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Ky planifikim është bazuar në programet e Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë (bërthamë) në arsimin e mesëm të lartë dhe përfshin njohuritë dhe aftësitë minimale (nota 5) që duhet të zotërojnë nxënësit për secilën kompetencë.

➤ **Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme:

- **Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij**

Nxënësi:

- përdor njohuritë paraprake (të fituara ndër vite) për të kuptuar në mënyrë shumë të përgjithshme tekstin (vetëm në linjën kryesore të tij);
- zbulon referentin në një tekst joletrar;
- parafrazon informacionin kryesor të tekstit;
- identifikon një përfundim të nxjerrë nga një tekst informues;
- identifikon idenë qendrore ose detajet kyçe të një teksti informues;
- identifikon qëndrimin e autorit rreth temës që po trajton;
- lokalizon informacionin brenda një teksti;
- përdor kontekstin për të përcaktuar kuptimin e një fjale në një tekst të dhënë;
- identifikon një fjalë apo disa fjalë të përdorura për të përshkruar një njeri, objekt apo ngjarje në një tekst të dhënë;
- zbulon detaje të thjeshta përshkruese (si: mbiemra cilësorë apo epitete) të dhëna në tekst;

- identifikon elementet pamore (fotografi, ilustrime) të përdorura në tekstet e shkruara për të arritur qëllime të ndryshme;
- identifikon karakteristikat e dukshme të formës së jashtme të teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafët zhvillues;
- identifikon temën apo motivin kryesor të tekstit;
- dallon gjuhën e drejtpërdrejtë nga ajo e figurshme në një tekst.

- **Pasurimi i fjalorit**

Nxënësi:

- përdor relativisht saktë fjalët në kuptimet e drejtpërdrejta të tyre.

➤ **Kompetenca:** Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale:

- **Shkrimi si proces**

Nxënësi:

- përpiqet të krijojë ose mbledhë ide të përshtatshme për punët me shkrim;
- përpiqet të shkruajë saktë nga pikëpamja drejtshkimore (përdor deri diku drejt pikën, pikëpyetjen, shkronjën e madhe në fillim të fjalisë apo në emrat e përveçëm).

- **Shkrimi si produkt**

Nxënësi:

- i përmbahet temës së esesë (përpiqet të organizojë fakte dhe ide në përshtatje me temën);
- përpiqet të organizojë paragrafë në trajtimin e temës së esesë.

- **Llojet e teksteve**

Nxënësi:

- përpiqet të shkruajë paragrafë përshkrues, rrëfyes apo argumentues në punën me shkrim.

➤ **Kompetenca:** Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit:

- **Morfologji**

Nxënësi:

- identifikon *klasat e fjalëve* (emër, mbiemër, folie, ndaifolie):

- dallon ligjërimin *bisedor* nga ai *libror*;
- dallon stilin e letërsisë artistike.

- **Drejtshkrim dhe pikësim**

Nxënësi:

- shkruan drejt *emrat* dhe *mbiemrat* në *numrin shumës*;
- përdor drejt shenjat e pikësimit si: *pika* dhe *pikëpyetja*.

➤ **Kompetenca:** Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare:

- **Letërsia dhe gjinitë letrare**

Nxënësi:

- dallon gjininë epike, lirike dhe dramatike;
- identifikon tekstin poetik, dramatik, rrëfimtari, nisur nga struktura e jashtme e tekstit.

- **Figurat stilistike**

Nxënësi:

- identifikon *epitetet*, *krahasimet*, *antitezën*, *hiperbolën* në tekste të ndryshme letrare;
- dallon *pyetjen retorike*;
- dallon *enumeracionin* në një tekst të thjeshtë.

- **Elementet e tekstit letrar**

a) Fabula dhe subjekti

Nxënësi:

- dallon *ngjarjet kryesore* të një fragmenti që shënojnë *hyrjen*, *zhvillimin*, *zgjidhjen*;
- dallon *konfliktin kryesor* në vepër.

b) Personazhet

Nxënësi:

- evidenton *personazhin kryesor* nga ata dytësorë;

- evidenton *ngjashmëritë* ose *dallimet* mes personazheve (*pamja, karakteri, sjelljet*);
- dallon *llojet e personazheve* (*reale, të trilluara, mitologjike, të jashtëzakonshme*);

c) Mjedisi, koha dhe atmosfera

Nxënësi:

- përshkruan (në mënyrë shumë të përgjithshme, *me një numër minimal fjalësh*) mjedisin dhe kohën në një vepër letrare;
- veçon *mjetet më të dallueshme artistike* (*epitete, krahasime, antiteza etj*) që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën;

d) Tematika

Nxënësi:

- dallon *temën* e një teksti;
- dallon *motivin kryesor* të një teksti.

MATEMATIKË

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Matematikës në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Numri”

Nxënësi:

- gjen prerjen dhe bashkimin e dy bashkësive të fundme;
- zbaton radhën e veprimeve duke përfshirë mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim;
- njehson SHVP dhe PMP të dy numrave natyrorë;
- kthen numrat dhjetorë të fundmë në thyesa dhe anasjellas (p.sh 3,5 në $7/2$ ose 0,375 në $3/8$);
- shpreh si raport ose thyesë një marrëdhënie ndërmjet dy madhësive;
- kthen përqindjen në thyesë ose në numër dhjetor;
- zbaton vetitë e fuqive me eksponent racional.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Matja”

Nxënësi:

- kthen njësitë standarde (p.sh, kohën, gjatësinë, masën);
- përdor njësitë e matjes dhe konceptet përkatëse (gjatësi, syprinë, vëllim, masë, kohë, lekë);
- njehson perimetrin e figurave plane;
- njehson syprinën e figurave plane kur jepen elementët përcaktues të tyre;
- zbaton teoremën e Pitagorës në trekëndëshin kënddrejtë;
- zbaton mbledhjen dhe zbritjen e vektorëve me dy koordinata;
- zbaton shumëzimin e vektorëve me një numër;
- zbaton formulën themelore të trigonometrisë kur jepet $\sin \alpha$ dhe $\cos \alpha$ ($\sin^2 \alpha + \cos^2 \alpha = 1$).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Gjeometria”

Nxënësi:

- përdor termat dhe simbolet përkatëse: pikë, drejtëz, kulm, brinjë, drejtëza paralele, drejtëza pingule;
- zbaton vetitë e këndeve me kulm të përbashkët, shtuese, plotësuese, kënde të kundërt në kulm etj;
- dallon brinjët kongruente të trekëndëshit dhe këndet kongruente të tij.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Algjebra dhe funksioni”

Nxënësi:

- zëvendëson vlerën e ndryshores dhe gjen vlerën e shprehjes shkronjore;
- mbledh dhe zbret monomet e ngjashme;
- identifikon koeficientin këndor të drejtëzës kur jepet ekuacioni i saj;
- gjen koordinatat e një pike në drejtëz kur njih njëërën prej tyre;
- zgjidh në mënyrë algjebrike ekuacione lineare me një ndryshore;
- zgjidh në mënyrë algjebrike ekuacione të fuqisë së dytë, duke përdorur formulën përkatëse;
- zgjidh inekuacione lineare me një ndryshore në mënyrë algjebrike;
- paraqet bashkësinë e zgjidhjeve në boshtin numerik, përdor simbolet e bashkësisë;
- gjen kufizën e vargut sipas rregullit të dhënë;
- gjen derivatin e rendit të parë të $f(x) = x^n$.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Statistika dhe probabiliteti”

Nxënësi:

- njehson mesataren, modën, amplitudën, mesoren për disa të dhëna;
- njehson rezultatet e pritshme të një eksperimenti;
- gjen probabilitetin e një ngjarjeje të rastit.

GJUHË E HUAJ

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Kompetencat minimale që duhet të zotërojë nxënësi për të arritur nivelin kalues në testin e Maturës Shtetërore 2020 në gjuhën e huaj, **Niveli B1**, jepen në tabelën e mëposhtme për çdo aftësi gjuhësore që testohet në këtë provim.

Minimal or basic competencies for Level B1 test in Reading Comprehension
Students at this level: - understand simple factual texts related to topics on everyday life or vocational subjects; - understand the general meaning of a simple text written in Standard English; - understand and find facts or details which can be easily found in a text; - understand different types of texts such as: short stories, advertisements, announcements, leaflets that have a simple language; - understand fiction text written in simple structured language; - paraphrase very simple words or word groups extracted from the text; - identify the types of the written texts.
Minimal or basic competencies for Level B1 test in Use of Language
Students at this level: - use correctly simple verb tenses (Simple Present, Simple Past, and Future tense); - use simple and basic vocabulary related to everyday life and activities; - use the comparison of adjectives correctly; - use simple structures in conversational English; - use correctly the most used prepositions and prepositional phrases (in, on, at); - use some of the most common modal verbs (can, may, must).
Minimal or basic competencies for Level B1 test in Writing
Students at this level: - write about an event, a simple description, using a limited range of language. - write an informal or semi-formal letter or email using very simple sentences and structures not paying too much attention to grammar or spelling; - rarely use compound sentences combining the verb tenses not correctly; - use simple linkers (and, but, because) not paying too much attention to punctual mistakes.

Kompetencat minimale që duhet të zotërojnë nxënësi për të arritur nivelin kalues në testin e Maturës Shtetërore 2020 në gjuhën e huaj, **Niveli B2**, jepen në tabelën e mëposhtme për çdo aftësi gjuhësore që testohet në këtë provim.

Minimal or basic competencies for Level B2 test in Reading Comprehension
Students at this level: - identify the types of texts; - understand the gist of the text; - locate easily found details in a text such as dates, statistics, etc.; - paraphrase the meaning of most frequent words/phrases in a text; - understand the message of the text when it is not too complicated or complex; - understand different types of texts such as fiction, non-fiction, articles, correspondence, reviews, written in a non-complex language; - read and understand correspondence, relating to his/her field of interest, grasping the essential meaning.
Minimal or basic competencies for Level B2 test in Use of Language
Students at this level: - use correctly compound tenses (perfect tenses, progressive tenses, future tenses); - use simple conversational structures; - use complex sentences, but committing mistakes mostly in sequence of tenses; - use comparisons of most frequent adverbs; - use the most used prepositions and prepositional phrases (in, on, at, by, with, etc.); - use correctly or with a few mistakes the most common phrasal verbs; - use correctly vocabulary related to their fields of interests.
Minimal or basic competencies for Level B2 test in Writing
Students at this level: - write formal letters not paying too much attention to all the steps of its structure; - write simple sentences or compound sentences using the simplest linkers such as (and, but, because) not paying too much attention to verbs tenses combination; - write formal letters related to their fields of interest such as school applications using an everyday vocabulary and simple language structures.

PROVIMI ME ZGJEDHJE:

KIMI

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e kimisë në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Struktura e Atomit”

Nxënësi:

- përshkruan vendndodhjen e grimcave përbërëse të atomit;
- përcakton numrin e protoneve, neutroneve, elektroneve në atomet ose jonet kur jepen numri atomik dhe numri i masës; (te atomet dhe jonet e elementeve të periodës 1,2,3);
- tregon simbolikën e paraqitjes së izotopeve;
- përshkruan dhe skicon format e orbitaleve s dhe p;
- shkruan formulat dhe konfigurimet elektronike të atomeve deri në 20 elementet e para të tabelës periodike.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Sistemi periodik”

Nxënësi:

- përshkruan metalet dhe jometalet (vetitë fizike);
- shkruan reaksione të thjeshta të metaleve si për shembull bashkëveprimin e tyre me acidet e holluara dhe me oksigjenin;
- përkufizon termat: rreze atomike, potencial jonizimi, afëri për elektronin, elektronegativitet dhe tregon si ndryshojnë ato te metalet dhe jometalet.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Lidhja kimike”

Nxënësi:

- përshkruan formimin e lidhjes jonike, lidhjes kovalente dhe kovalente polare;
- përshkruan formimin e lidhjeve dyfishe dhe trefishe;
- shkruan formula kimike të përbërjeve me lidhjet e mësipërme;
- tregon me shembuj të thjeshtë cilat janë forcat e bashkëveprimit ndër molekular.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Struktura dhe lidhjet e karbonit”

Nxënësi:

- tregon se karboni mund të formojë katër lidhje kovalente;
- përshkruan strukturat kovalente të grafitit dhe diamantit.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Përbërjet organike”

Nxënësi:

- tregon grupet funksionore në formulat kimike të përbërjeve organike;
- shkruan formula të alkaneve, alkeneve, acideve dhe alkooleve, deri në 10 atome karboni;
- emërton përbërje organike sipas klasave të mësipërme;
- kryen njehsime të thjeshta në to, si njehsimi i masës molare.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Njehsime stekiometrike”

Nxënësi:

- kryen njehsime të thjeshta për përcaktimin e masës molare, vëllimit të substancave të gazta kur dihet numri i moleve;
- tregon me shembuj të thjeshtë reaksionesh si zbatohet ligji i ruajtjes së masës;
- kryen njehsime të thjeshta në reaksione kimike.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Acidet dhe bazat”

Nxënësi:

- përkufizon acidet, bazat, oksidet, kripërat, oksikripërat;
- shkruan reaksione të thjeshta për të treguar vetitë e tyre.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Termokimia”

Nxënësi:

- përkufizon reaksionet ekzotermike edhe endotermike nga pikëpamja e nxehtësisë së reaksionit;
- përshkruan kalorimetrin dhe pse përdoret ai;
- përcakton ΔH e një reaksioni nga rezultatet e dhëna eksperimentale, duke përdorur formulën $\Delta H = -mc\Delta T$;
- përkufizon ligjin e Hesit dhe rrjedhimet e tij;
- kryen njehsime të thjeshta rreth tyre.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Kinetika kimike”

Nxënësi:

- përkufizon shpejtësinë e reaksionit kimik;
- përshkruan ndikimin e faktorëve në shpejtësinë e një reaksioni kimik;
- kryen njehsime të thjeshta për përcaktimin shpejtësisë së reaksionit.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Ekuilibri kimik”

Nxënësi:

- përshkruan ekuilibrin kimik si një ekuilibër dinamik;
- tregon marrëdhënien ndërmjet sistemeve në ekuilibër dhe parimit Le Shatelje (ndikimi i faktorëve: temperature, trysni, përqendrim);
- shkruan shprehjen matematike të konstantes së ekuilibrit kimik dhe kryen njehsime të thjeshta.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Ekuilibri jonik”

Nxënësi:

- shkruan formula acidesh dhe bazash të dobëta e të forta;
- njehson pH e tyre;
- tregon kuptimin e termave K_a , K_b , K_{Pt} etj.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Elektrokimia”

Nxënësi:

- përcakton numrin e oksidimit të atomit të çdo elementi në përbërjet dhe jonet duke zbatuar rregullat përkatëse;
- përshkruan si kryhet elektroliza e NaCl (tretësirë ujore dhe në gjendje të shkrirë), si dhe ndërtimin e elementit galvanik;
- tregon (në shembuj të thjeshtë elektrolize), rregullat e shkarkimit të joneve.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Reaksionet në përbërjet organike”

Nxënësi:

- përkufizon reaksionin e adicionit, të djegies, eliminimit;
- shkruan reaksionet e kalimit nga alkanet - në alkene – alkoole-acide.

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e fizikës në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Kinematika”

Nxënësi:

- përshkruan kuptimin fizik të rrugës, zhvendosjes, shpejtësisë dhe nxitimit;
- shpjegon konceptin e shpejtësisë së çastit dhe shpejtësisë mesatare;
- njehson rrugën, zhvendosjen, shpejtësinë dhe nxitimin e trupit gjatë lëvizjes;
- dallon lëvizjen me nxitim konstant nga lëvizja me nxitim të ndryshueshëm;
- përcakton me metodën grafike shpejtësinë fillestare, shpejtësinë përfundimtare, nxitimin dhe zhvendosjen e trupit në një interval të dhënë kohe;
- njehson zhvendosjen e trupit duke u nisur nga grafiku i shpejtësisë nga koha;
- shpjegon rënien e lirë të trupave nëpërmjet eksperimentit dhe e trajton atë si rast i veçantë i lëvizjes drejtvizore njëtrajtësisht të përshpejtuar;
- shkruan ekuacionet e lëvizjes së rënies së lirë të trupave, duke u bazuar në ekuacionet e lëvizjes drejtvizore njëtrajtësisht të ndryshueshme.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Dinamika”

Nxënësi:

- përkufizon dhe zbaton ligjin I të Njutonit;
- përkufizon dhe zbaton ligjin e dytë të Njutonit, që shpreh lidhjen ndërmjet forcës, masës, dhe nxitimit të trupit;
- përkufizon dhe zbaton ligjin e tretë të Njutonit në shembuj situatash të ekuilibrit të forcave që veprojnë mbi trupin;
- ndërton vektorialisht forcat që veprojnë mbi një trup ose mbi një sistem trupash dhe njehson rezultanten e tyre;
- njehson forcën e fërkimit kur trupi lëviz në një rrafsh horizontal dhe në rrafshin e pjerrët;
- interpreton llojet e fërkimit në situata të jetës së përditshme;
- zbaton ligjin e tërheqjes së gjithësisë në zgjidhjen e problemave;
- zbaton ligjin e ruajtjes së impulsit kur trupat, që bashkëveprojnë kryejnë goditje elastike dhe jo elastike.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Puna dhe Energjia”

Nxënësi:

- zbaton formulën që shpreh punën e kryer mbi trupin për zhvendosjen e tij nga një forcë konstante;
- njehson grafikisht punën e kryer mbi trupin që zhvendoset nga një forcë konstante;
- njehson punën e forcës së rëndesës;
- shpjegon se trupi ka aftësi të kryejë punë kur zotëron energji;
- njehson energjinë kinetike dhe shpjegon se këtë energji e zotëron trupi në sajë të lëvizjes;
- njehson energjinë potenciale gravitacionale dhe shpjegon se këtë energji e zotërojnë trupat në sajë të bashkëveprimit ndërmjet tyre (ose ndërmjet pjesëve të veçanta të të njëjtit trup);
- dallon energjinë potenciale gravitacionale me energjinë potenciale të elasticitetit;
- zbaton teoremën e energjisë kinetike në zgjidhjen e problemave.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Fizika Molekulare dhe Termodinamika”

Nxënësi:

- njehson temperaturën absolute, kur njohim temperaturën në gradë Celsius: $T = 273^0 + t$;
- përdor shkallën gradë Celsius si njësi matëse e temperaturës së trupit, dhe shkallën gradë Kelvin për temperaturën absolute;
- përdor ekuacionin e përgjithshëm të gjendjes së gazit ideal në zgjidhjen e problemave;
- përdor formulat për të njehsuar energjinë e brendshme të gazit ideal;
- shpjegon eksperimentalisht ligjet e veçanta të gazeve;
- ndërton grafikun e procesit izohorik, izobarik dhe izotermik;
- zbaton ligjet e veçanta të gazeve në zgjidhjen e problemave;
- shpjegon se puna e kryer nga gazi (sistemi) varet jo vetëm nga gjendjet fillestare dhe përfundimtare, por edhe nga karakteristikat e procesit dhe e njehson atë;
- njehson nxehtësinë, punën dhe energjinë termike duke zbatuar parimin e parë të termodinamikës.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Elektrostatika”

Nxënësi:

- bën dallimin ndërmjet forcës elektrike dhe intensitetit të fushës elektrike;
- njehson fushën elektrike të një ngarkese pikësore;
- paraqet forcën që vepron mbi një ngarkesë të vendosur në një fushë elektrike të njëtrajtshme;
- tregon se diferenca potenciale ndërmjet dy pikave të fushës elektrike është e barabartë me punën që kryejnë forcat e fushës elektrike gjatë zhvendosjes së ngarkesës (+ 1 C) nga njëra pikë në tjetrën;
- njehson forcën elektrike me të cilën bashkëveprojnë dy ngarkesa pikësore, duke zbatuar ligjin e Kulonit;
- njehson punën e kryer nga fusha elektrike mbi një ngarkesë që zhvendoset në këtë fushë;
- shpjegon ndërtimin e kondensatorit dhe shpjegon konceptin fizik të tij;
- njehson kapacitetin e kondensatorit në varësi të përmasave të tij;
- njehson shumën e dy kondensatorëve kur lidhen në seri dhe në paralel;
- zbaton formulën që shpreh lidhjen ndërmjet diferencës potenciale dhe intensitetit të fushës elektrike.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Rryma Elektrike”

Nxënësi:

- njehson rezistencën elektrike të një përcjellësi në varësi të llojit të materialit, gjatësisë dhe sipërfaqes së prerjes tërthore;
- njehson rezistencën e përgjithshme të qarkut për rezistencat e lidhjes në seri dhe paralel;
- ndërton skemat ekuivalente të qarqeve elektrike me lidhje të përzier;
- zbaton ligjin e Omit për një pjesë homogjene, qarkun e plotë homogjen, për një pjesë heterogjene të qarkut elektrik;
- përdor saktë njësitë e punës, tensionit, rrymës, rezistencës, f.e.m dhe fuqisë;
- njehson rrymën që kalon në secilën rezistencë të qarkut elektrik;
- njehson tensionin që zbatohet në secilën rezistencë të qarkut elektrik;
- ndërton dhe interpreton grafikët e rrymës në varësi të tensionit për temperatura të ndryshme;
- interpreton ligjin e Xhaul-Lencit, si ligj i shndërrimit të energjisë elektrike në energji termike;
- zbaton ligjin e Xhaul-Lencit në zgjidhjen e problemave;
- njehson fuqinë termike të rrymës.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Fusha Magnetike”

- Nxënësi:
- përcakton drejtimin e vijave të forcës së fushës magnetike të një përcjellësi drejtvizor me rrymë ose të një spire me rregullën e dorës së djathtë;
- zbaton ligjin e Amperit për të njehsuar forcën që ushtron fusha magnetike mbi përcjellësin me rrymë;
- zbaton rregullën e dorës së majtë për përcaktimin e drejtimit të forcës magnetike mbi përcjellësin me rrymë;
- njehson forcën e Lorencit, si forcë që ushtrohet mbi ngarkesat elektrike kur ato lëvizin në një fushë magnetike;
- njehson rrezen e rrethit sipas të cilit lëviz një thërmijë e ngarkuar me masë m , e cila lëviz me shpejtësi v , kur hyn pingul me vijat e fushës magnetike të njëtrajtshme me induksion B ;
- shpjegon kuptimin fizik të fluksit magnetik, njehson fluksin magnetik dhe ndryshimin e tij;
- tregon se për sa kohë në një përcjellës të mbyllur ndryshon fluksi magnetik, që përshkon përcjellësin, në të lind rrymë e induktuar;
- zbaton ligjin e Faradeit për njehsimin e f.e.m. të induktuar në përcjellësin e mbyllur me rrymë.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Lëkundjet dhe valët”

Nxënësi:

- përkufizon madhësitë që karakterizojnë lëvizjen lëkundëse periodike: amplitudë, periodë, frekuencë, frekuencë këndore, diferencë faze;
- përdor ekuacionin e lëkundjeve harmonike, si funksion sinusoidal ose kosinusoidal i zhvendosjes nga koha;
- ndërton grafikët e $x=f(t)$, $v=f(t)$, $a=f(t)$ në lëkundjet e thjeshta harmonike;
- njehson periodën dhe frekuencën e lavjerrësit elastik (trup –sustë) dhe lavjerrësit të thjeshtë;
- zbaton ligjin e shndërrimit dhe ruajtjes së energjinë mekanike për sistemin trup-sustë dhe lavjerrësin matematik;
- përshkruan madhësitë fizike që karakterizojnë valën mekanike: (zhvendosje, amplitudë, gjatësi vale, fazë, diferencë fazë, periodë, frekuencë dhe shpejtësi e valës);
- përdor formulën që shpreh lidhjen e shpejtësisë së valës, frekuencës dhe gjatësisë së saj.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Optika Gjeometrike”

Nxënësi:

- përshkruan dhe zbaton ligjin e pasqyrit dhe të përthyerjes së dritës;
- ndërton shëmbëllimin e përftuar nga një pasqyrë e rrafshët dhe tregon karakteristikat e tij;
- demonstroi dukurinë e pasqyrit dhe përthyerjes së dritës, kur kalon në mjedise me tregues përthyerje të ndryshëm;
- ndërton drejtimin e rrezeve të dritës kur kalojnë në një pllakë qelqi me faqe paralele;
- përkufizon madhësitë që karakterizojnë thjerrat (vatër e thjerrës, largësi vatrore, treguesit e përthyerjes së mjediseve, shëmbëllim real dhe virtual, fuqi optike);
- ndërton shëmbëllimet e përftuar nga thjerrat përmbledhëse dhe shpërndarëse dhe liston karakteristikat e shëmbëllimeve (real-virtual, i drejtë- i përmbysur, i zmadhuar- i zvogëluar).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Fizika Kuantike”

Nxënësi:

- shpjegon hipotezën e De-Brojlit për dualizmin grimcë-valë , duke theksuar se jo vetëm rrezatimi ka natyrë grimcore, por edhe thërmijat e lëndës kanë natyrë valore;
- zbaton formulën e De-Brojlit, që shpreh dualizmin valë –thërmijë;
- përshkruan kuptimin fizik të fotonit dhe njehson energjinë e tij, për një frekuencë të dhënë;
- zbaton ekuacionin e Ajnshtajnit për dukurinë e foto efektit në zgjidhjen e problemave;
- përcakton frekuencën prag për të cilën ndodh foto efekti.

BIOLOGJI

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Biologjisë në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Diversiteti”

Nxënësi:

- tregon rëndësinë e karbohidrateve për jetën;
- emërton monomerët e karbohidrateve;
- tregon rëndësinë e lyrave për jetën;
- emërton monomerët e lyrave;
- tregon rëndësinë e proteinave për jetën;
- emërton monomerët e proteinave;
- tregon rëndësinë e acideve nukleike për jetën;
- emërton monomerët e acideve nukleike;
- emërton bazat e azotuara të ADN-së;
- emërton bazat e azotuara të ARN-së;
- liston organelet e qelizës prokariote;
- identifikon në figurë organelet e qelizës prokariote;
- liston organelet e qelizës eukariote;
- identifikon në figurë organelet e qelizës eukariote.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Ciklet”

Nxënësi:

- shkruan me fjalë komponimet nistore dhe produktet e procesit të fotosintezës;
- shkruan me fjalë komponimet nistore dhe produktet e procesit të frymëmarrjes qelizore;
- tregon dallimin midis kompletit kromozomik të qelizave somatike (trupore) dhe qelizave seksuale të njeriut;
- tregon dallimet kryesore midis qelizës seksuale femërore (vezës) dhe qelizës seksuale mashkullore (spermatozoidit).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Sistemet”

Nxënësi:

- emërton pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të frymkëmbimit te njeriu;
- identifikon në figurë pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të frymkëmbimit te njeriu;
- emërton njësine ndërtuese dhe funksionale të mushkërive te njeriu;
- identifikon në figurë pjesët përbërëse të alveolave (hojëzave);
- emërton pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të qarkullimit të gjakut te njeriu;
- emërton qelizat që marrin pjesë në përbërjen e gjakut te njeriu;
- identifikon në figurë pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të qarkullimit të gjakut te njeriu;
- emërton pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të tretjes te njeriu;
- identifikon në figurë pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të tretjes te njeriu;
- emërton pjesët kryesore ndërtuese të sistemit nervor te njeriu;
- identifikon në figurë pjesët kryesore ndërtuese të sistemit nervor te njeriu;
- emërton njësine ndërtuese dhe funksionale të sistemit nervor;
- identifikon në figurë pjesët përbërëse të neuronit;
- emërton pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të ekskretimit te njeriu;
- identifikon në figurë pjesët kryesore ndërtuese të sistemit të ekskretimit te njeriu;
- emërton njësine ndërtuese dhe funksionale të veshkave;
- identifikon në figurë pjesët përbërëse të nefronit;
- emërton pjesët kryesore ndërtuese te bimët farëveshura;
- identifikon në figurë pjesët kryesore ndërtuese te bimët farëveshura.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Ndërveprimet”

Nxënësi:

- emërton pjesët përbërëse të ekosistemit;
- tregon nivelet trofike të një zinxhiri ushqimor.

HISTORI

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Historisë në MSH 2020.

Ky udhëzues është bazuar në programin orientues të Maturës Shtetërore për lëndën e historisë dhe përfshin njohuritë dhe aftësitë minimale (nota 5) që duhet të zotërojnë nxënësit për secilën tematikë.

Rezultatet e të nxënit për tematikën Antikiteti

Nxënësi:

- identifikon vendndodhjen e qytetërimeve të hershme;
- identifikon arritjet kryesore në qytetërimet antike greke dhe romake;
- identifikon fiset kryesore ilire dhe territoret e shtrirjes së tyre.

Rezultatet e të nxënit për tematikën Mesjeta (shek. IV-XIV)

Nxënësi:

- përshkruan tiparet e organizimit shtetëror të Perandorisë Bizantine;
- identifikon arritjet kryesore të Perandorisë Bizantine;
- rendit çështjet themelore që përmbante Karta e Madhe e Lirive;
- përshkruan tiparet kryesore të Principatës së Arbrit.

Rezultatet e të nxënit për tematikën Periudha moderne (shek. XV-XX)

Nxënësi:

- identifikon vendimet e Kuvendit të Lezhës;
- identifikon shkaqet e “Zbulimeve të mëdha gjeografike”;
- identifikon ndryshimet themelore që solli reforma protestante;
- identifikon figurat kryesore të iluminizmit dhe arritjet kryesore të tyre;
- përshkruan përmbajtjen e Aktit mbi të Drejtat në Angli;
- rendit shkaqet e Revolucionit francez;
- identifikon arsyet përse Anglia u bë atdheu i Revolucionit të Parë Industrial;
- Identifikon arritjet kryesore të pashallëqeve shqiptare.

Rezultatet e të nxënës për tematikën Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)

Nxënësi:

- liston vendimet kryesore të Kongresit të Manastirit dhe Kongresit të Elbasanit;
- përcakton shtrirjen e pushtetit të qeverisë së përkohshme së Vlorës;
- identifikon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore;
- identifikon vendimet e Kongresit të Lushnjës;
- përshkruan kushtet historike të ardhjes në pushtet të Musolinit dhe Hitlerit;
- identifikon format e qeverisjes në Shqipëri në vitet 1925-1939;
- identifikon shkaqet e krizës së viteve 1929 – 1933 në SHBA;
- përshkruan drejtimet e politikës së jashtme të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1939;
- identifikon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore;
- identifikon veçoritë kryesore politike dhe ekonomike në Bllokun Perëndimor dhe atë Lindor;
- identifikon masat që mori regjimi komunist në fushën ekonomike dhe politike në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948;
- identifikon politikat ekonomike që ndoqi shteti shqiptar në vitet 1945-1990;
- identifikon format e shfaqjes së luftës së klasave në Shqipëri gjatë regjimit komunist.

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Gjeografisë në MSH 2020.

Ky udhëzues është bazuar në programin orientues të Maturës Shtetërore për lëndën e gjeografisë dhe përfshin njohuritë dhe aftësitë minimale (nota 5) që duhet të zotërojnë nxënësit për secilën tematikë.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Proceset natyrore dhe shoqërore”

Nxënësi:

- përcakton drejtimin e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet;
- përcakton drejtimin e lëvizjes të Tokës rreth Diellit;
- identifikon pasojat kryesore të rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet;
- identifikon pasojat kryesore të rrotullimit të Tokës rreth Diellit;
- identifikon nga një veçori kryesore të trupave të sistemit diellor (Dielli, Hëna, meteorët, asteroidet, kometat);
- përcakton pikat e horizontit në një hartë të dhënë;
- gjen në hartë koordinatat gjeografike të një pike të dhënë;
- përcakton shtresat e atmosferës, duke dhënë nga një karakteristikë kryesore për secilën;
- identifikon erërat lokale;
- identifikon faktorin kryesor që ndikon në formimin e rrymave oqeanike;
- përcakton faktorët që ndikojnë në formimin e valëve detare;
- identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e baticë-zbaticave;
- identifikon në figurë pjesët e një lumi;
- identifikon elementet e valës detare në një figurë;
- identifikon vetitë fizike (fortësia, shkëlqimi, ngjyra) të mineraleve;
- dallon llojet kryesore të shkëmbinjve (magmatikë, sedimentarë dhe metamorfikë);
- identifikon shtresat e Tokës në një figurë të dhënë;
- identifikon në figurë pjesët e vullkanit dhe produktet vullkanike;
- identifikon pasojat e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik;
- identifikon në hartë zonat sizmike dhe ato të vullkaneve.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve”

Nxënësi:

- përcakton pozitën gjeografike të rajoneve gjeografike të botës;
- përshkruan veçoritë kryesore natyrore të rajoneve të botës, si: format kryesore të relievit dhe lumenjtë kryesorë;
- identifikon në hartë rajonet e botës;
- identifikon në hartë gadishujt dhe ishujt kryesorë të rajoneve të botës;
- identifikon fetë kryesore në botë (islamizmi, krishterimi, judaizmi, hinduizmi, budizmi) dhe shpërndarjen e tyre;
- identifikon shkaqet e migracionit të popullsisë në botë;
- përcakton pozitën gjeografike të Republikës së Shqipërisë;
- përcakton strukturën ekonomike të Shqipërisë në periudha të ndryshme kohore;
- identifikon format kryesore të relievit (male, kodra, lugina, fusha) për çdo rajon të Shqipërisë;
- identifikon lumenjtë kryesorë për çdo rajon të Shqipërisë;
- rendit faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të rajoneve të Shqipërisë;
- identifikon karakteristikat kryesore të strukturës moshore, gjinore, etnike dhe fetare të popullsisë së Shqipërisë.

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Qytetarisë dhe Psikologjisë në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Rezultatet e të nxënit për lëndën “Qytetari”

Nxënësi:

- përcakton ligjin;
- identifikon funksionet e ligjit;
- identifikon vlerat në të cilat bazohet ligji;
- përshkruan rolin e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit;
- identifikon parimet themelore të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- përcakton të drejtat e njeriut;
- identifikon kategoritë kryesore të të drejtave të njeriut sipas legjislacionit ndërkombëtar;
- përshkruan tiparet kryesore të të drejtave të njeriut;
- identifikon problemet me të cilat përballet arsimi sot;
- identifikon armiq të shëndetit;
- dallon rreziqet me të cilat përballet planeti ynë sot;
- identifikon të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit;
- identifikon të drejtat e punëmarrësit dhe punëdhënësit;
- përcakton sinjalet kryesore rrugore që rregullojnë qarkullimin rrugor;
- identifikon mjetet tradicionale dhe të reja të informacionit;
- përshkruan detyrimet e përbashkëta të anëtarëve të komunitetit.

Rezultatet e të nxënit për lëndën “Psikologji”

Nxënësi:

- përshkruan nënfushat e psikologjisë;
- identifikon drejtimet kryesore të psikologjisë;
- identifikon metodat e studimit të psikologjisë;
- përshkruan funksionimin e neuronit;
- identifikon teoritë kryesore të motivacionit;
- përshkruan zhvillimin si proces jetësor;
- identifikon teoritë e zhvillimit njerëzor;
- përcakton teoritë për zhvillimin e personalitetit;
- identifikon parimet e të nxënit;
- përshkruan llojet kryesore të të mësuarit;
- identifikon llojet kryesore të kujtesës;
- përshkruan natyrën e ndërgjegjes;
- përcakton sjelljen jonormale;
- identifikon metodat që studiojnë sjelljen jonormale.

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Filozofisë dhe Sociologjisë në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Rezultatet e të nxënit për lëndën “Filozofi”

Nxënësi:

- përshkruan kushtet historikë dhe kulturorë që ndikuan në zhvillimin e filozofisë së antikitetit;
- identifikon pikëpamjet kryesore filozofike të Sokratit, Platonit dhe Aristotelit;
- dallon rrethanat që përcaktuan drejtimin e ri që mori filozofia gjatë periudhës romake;
- përshkruan pikëpamjet e tri rrymave filozofike në Romën e lashtë për arritjen e lumturisë dhe qetësisë shpirtërore;
- rendit arsyet pse periudha e Mesjetës u quajt periudha e errët;
- identifikon pikëpamjet kryesore të filozofëve gjatë periudhës së Mesjetës;
- përshkruan faktorët historikë dhe kulturorë që ndikuan në zhvillimin e filozofisë gjatë periudhës së Rilindjes;
- përshkruan rëndësinë e filozofisë politike të Hobsit dhe Xhon Lokut në krijimin e shtetit modern dhe liberal;
- rendit arsyet pse shekulli XVII njihet me emrin “epoka e arsyes”;
- përshkruan ndikimin që pati iluminizmi në zhvillimin e filozofisë në shekullin e XVIII.
- identifikon tiparet kryesore të ekzistencializmit;
- përshkruan rolin e edukimit dhe gjuhës si mjet komunikimi në shoqëri, bazuar në pikëpamjet e Djuitt dhe Vitgenshtajnit;
- përshkruan rolin e psikanalizës në zhvillimin e filozofive të shekullit XX.

Rezultatet e të nxënit për lëndën “Sociologji”

Nxënësi:

- dallon përbërësit e sistemeve kulturore;
- përshkruan faktorët që çuan në krijimin e nën kulturave dhe kundër kulturave në Shqipëri;
- rendit karakteristikat kryesore të shoqërizimit në çdo cikël të jetës;
- përshkruan tipat kryesorë të krimit;
- dallon format kryesore të lidhjeve martesore;
- përshkruan evolucionin e formave kryesore të familjes ;
- rendit karakteristikat kryesore të tri racave;
- përshkruan format e marrëdhënieve mes grupeve racore dhe etnike;
- rendit karakteristikat e organizatave fetare zyrtare dhe jo zyrtare;
- përshkruan karakteristikat e gjashtë feve botërore;
- dallon sistemin e kastave dhe sistemin e klasave;
- përshkruan tipat e lëvizjeve shoqërore;
- rendit karakteristikat e shoqërive tradicionale, moderne dhe pas moderne;
- përshkruan tiparet e metodave të kërkimit sociologjik.

Rezultatet e të nxënit për realizimin e nivelit minimal të kompetencave për testin e Ekonomisë në MSH 2020.

Prezantimi i kompetencave minimale ka për qëllim të ndihmojë nxënësit për të kuptuar se cilat janë rezultatet e arritjeve të tyre për nivelin minimal (notën 5).

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Çfarë studion Ekonomia”

Nxënësi:

- identifikon nevoja të pakufizuara dhe përballjen me burimet e kufizuara të subjekteve ekonomike;
- identifikon koston oportune në lidhje me vendime të ndryshme jo vetëm ekonomike;
- përshkruan karakteristikat e sistemeve ekonomike;
- identifikon shtyllat e sipërmarrjes së lirë.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut”

Nxënësi:

- përshkruan tregun dhe vendin e kërkesës dhe ofertës në të;
- identifikon faktorët që ndikojnë në kërkesën dhe ofertën për një produkt;
- dallon mallrat e domosdoshme dhe jo të domosdoshme për konsumatorët.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Konsumatori në ekonominë e tregut”

Nxënësi:

- rendit burime të të ardhurave për konsumatorin;
- identifikon arsyet e kursimit nga konsumatori.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij”

Nxënësi:

- rendit format kryesore të organizimit të biznesit;
- identifikon karakteristika të formave të organizimit të biznesit.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës”

Nxënësi:

- dallon faktorët kryesorë të prodhimit në një firmë;
- dallon periudhën afatshkurtër nga ajo afatgjatë të prodhimit në një firmë.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Strukturat e tregut”

Nxënësi:

- përshkruan strukturat e organizimit të tregut.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Tregjet e faktorëve të prodhimit”

Nxënësi:

- identifikon kërkesën dhe ofertën për punë, tokë dhe kapital.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Qeveria dhe ekonomia”

Nxënësi:

- identifikon funksionet e qeverisë në ekonomi;
- identifikon lloje të taksave, parime të taksimit dhe qëllime të taksimit.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Paraja dhe institucionet financiare”

Nxënësi:

- identifikon funksione të parasë, cilësi të parasë si mjet këmbimi;
- identifikon funksione të Bankës qendrore dhe bankave të nivelit të dytë.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Treguesit kryesorë makroekonomikë”

- Nxënësi:

- përshkruan treguesit kryesorë makroekonomikë;
- identifikon GDP, GDP nominale, GDP reale.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike”

Nxënësi:

- evidenton mjetet e politikës fiskale dhe monetare.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Tregtia ndërkombëtare”

Nxënësi:

- përcakton faktorë që ndikojnë eksportin dhe importin e një ekonomie;
- identifikon faktorë që ndikojnë kursin e këmbimit.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Etika e biznesit”

Nxënësi:

- përshkruan elemente të etikës së biznesit;
- identifikon përparësi etike.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Aftësi për sukses”

Nxënësi:

- identifikon aftësi për sukses.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Financat personale”

- përshkruan përbërësit themelorë të financave personale, si të ardhurat, shpenzimet, kursimi, fitimi, kredia, investimi, menaxhimi i rriskut, etj;
- identifikon risqe të mundshme për financat e tij personale.

Rezultatet e të nxënit për tematikën “Bëhu sipërmarrës”

Nxënësi:

- përshkruan karakteristikat dhe praktikat e një sipërmarrjeje të suksesshme;
- identifikon pasoja afatshkurtra dhe afatgjata të marrjes së vendimeve etike.